



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:162499

Datë: 09.09.2024

Numri i dokumentit: 06138293

KE.nr. 490/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike të paditësit Getoari Sh.P.K. me seli në Prizren, rr. “Tirana” p.nr., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Bahrie Besimi, avokate nga Prizreni, kundër të paditurit Këshilli i Bashkësisë Islame në Prizren, rr. “Bajraklia” nr.17, me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës, me datë 09.09.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia e ushtruar nga paditësi Getoari Sh.P.K. me seli në Prizren kundër të paditurit Këshilli i Bashkësisë Islame në Prizren, me objekt kontesti kompensim dëmi, lënda e identifikuar me shenjën KE.nr. 490/22 (lidhja C.nr.1131/19).

A r s y e t i m

Paditësi Getoari Sh.P.K. me seli në Prizren, përmes të autorizuarës së tij, me datë 29.07.2019 ka paraqitur padi kundër të paditurit Këshilli i Bashkësisë Islame në Prizren, për kompensimin e dëmit.

Me datë 28.08.2024, përfaqësuesja e paditësit, me anë të parashtresës e ka njoftuar Gjykatën se për këtë çështje juridike e tërheqë padinë e parashtruar me datë 29.07.2019 me vullnet të lirë, pa kërcënim nga askush dhe për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe, si dhe për shkak të konsideratës ndaj të paditurit.

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtresës së përfaqësuesit të paditësit, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c) dhe nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2019:162499
Datë: 09.09.2024
Numri i dokumentit: 06138293

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 490/22, datë 09.09.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.